

LIGJ
Nr. 26/2026

PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 69/2012, “PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 47 shtohet neni 47/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 47/1
Programi “pas shkolle”

1. Programi “pas shkolle” përfshin programin jo të detyrueshëm të veprimtarive të organizuara dhe të strukturuar, të cilat zhvillohen jashtë orarit mësimor të detyruar dhe ka për qëllim përforcimin e të nxënit, zhvillimin gjithëpërfshirës të aftësive edukative, sociale, sportive, kulturore dhe krijuese të nxënësve, veprimtari të cilat zhvillohen nëpërmjet trajnuesve.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin financon programin “pas shkolle” nga fondi buxhetor i miratuar për këtë qëllim, për çdo vit buxhetor, nëpërmjet akordimit të fondeve për zyrat vendore të arsimit parauniversitar për realizimin e këtij programi.

3. Organizimi dhe zhvillimi i programit “pas shkolle”, kategoritë, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes, shpërblimi i trajnuesve, si dhe mënyra e financimit të këtij programi bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Llojet e programit “pas shkolle”, standardet, kriteret, plani i veprimit për ofrimin e këtij programi, si dhe përcaktimi i institucioneve publike të arsimit parauniversitar ku zhvillohet programi bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 2

Në kreun XI, neni 64, pika 2, togfjalëshi “deri në moshën 19 vjeç” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në moshën 21 vjeç.”.

Neni 3

Në nenin 72 pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Personeli mësimdhënës/edukator, që zotëron diplomë të ciklit të parë dhe ose të dytë të studimeve të arsimit të lartë ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, që është punësuar në sistemin arsimor me kohë të plotë dhe pa afat përpara datës 1.3.2017, pavarësisht nivelit të diplomës dhe kualifikimit, diploma e përfutur i njihet si arsim i lartë, tetë semestra, për efekt page.”.

Neni 4

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 47/1, pika 3, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për arsimin që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor në zbatim të nenit 47/1, pika 4, të këtij ligji.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 5.3.2026.

Shpallur me dekretin nr. 226, datë 9.4.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.